



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2001/3 prot

Datë 23/ 08 /2023

**V E N D I M**

**Nr. 803/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23/ 08 /2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*” me Nr. **REF-77239-08-10-2023**, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në **2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj**”, **Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1** “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në **zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve**), me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 21.08.2023, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

**Autoriteti Kontraktor:** Spitali Rajonal Vlorë  
Adresa: Lagjja “ Partizani”.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices” SHPK  
Adresa: Njësia nr. 8, Rruga Siri Kodra, Objekti nr. 198-Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 11.08.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. **REF-77239-08-10-2023**, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në 2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë**

të përcaktuara - me afat 12 muaj”, Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1 “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës konçesionare të laboratorëve), me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 21.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

II.2. Në datën 15.08.2023, operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Njëpërmjet shkresës nr. 3218 prot., datë 17.08.2023, protokolluar me tonën me nr. 2001/2 prot., datë 21.08.2023 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Distributor of Medical Devices” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Distributor of Medical Devices” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, duke pranuar pretendimet lidhur me pikën 2.3.8 të ankesës.

Konkretisht, autoriteti kontraktor ka cituar: “*Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK. Tubat e laboratorit janë shumë specifike dhe lidhen drejtpërdrejtë me nxjerrjen e rezultateve të analizave të pacientëve. AK bën ndryshimet për orën e paraqitjes së mostrave në datën dhe orën e dorëzimit të ofertave, si më poshtë:*

*2.3.8. Kërkohen të paraqiten mostrat për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i kampionëve/mostrave të bëhet pranë Drejtorisë së Spitalit Vlorë, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilën/at të shënohet: ”Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të kësaj procedure prokurimi dhe jo para datës 21.08.2023, ora 10:00.*

*-Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.*

*-Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës.*

*Ndodhur në këto kushte, nga ana e Autoritetit kontraktor ankesa e paraqitur nga OE merret parasysh pjesërisht”.*

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën në përputhje me këtë pretendim të pranuar. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të marrë masa për publikimin në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, të shtojcës për modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, në përputhje me pretendimin e pranuar pjesërisht.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Distributor of Medical Devices” SHPK, për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, duke ndryshuar kriterin e veçantë të kualifikimit për nevojën e disponimit të një fuqie puntorie prej “...sa më sipër kërkojmë që ky kriter të modifikohet duke përcaktuar një vlerë limit të xhiros jo më të madhe se 40% e vlerës së fondit limit pra vlera maksimale të përcaktohet deri në 40%...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në pikën 2.2.1, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

*2.2.1. Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2020, 2021 dhe 2022) ku vlera e tyre te jete jo me e vogel se 40 % e vlerës së fondit limit te lotit ose shumatores se loteve për të cilat konkurron operatori.*

*Shënim\*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilen ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10.*

*Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.*

#### **Për secilin lot**

III.1.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3 “Parime të përgjithshme” 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për

operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

III.1.3. Në pikën 3 të nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me

*aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”.*

Në pikën 1 të nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se:

*“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare<sup>1</sup>.*

*2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

*a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit<sup>2</sup>, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*

*b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

*c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

*3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

*4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit<sup>3</sup>.*

*5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës”.*

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për

autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, zotërojnë kapacitetin ekonomik e konkretisht xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 viteve të fundit financiare (2020, 2021,2022). Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe hartimi i dokumenteve të tenderit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit te kriteret e veçanta për kualifikim kapaciteti ekonomik, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë *“Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2020, 2021 dhe 2022) ku vlera e tyre te jete jo me e vogel se 40 % e vlerës së fondit limit te lotit ose shumatores se loteve për të cilat konkurron operatori.*

*Shënim\*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilen ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10.*

*Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur. Për secilin lot, ndërsa në nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”. Ndërkohë në nenin 43, pikat 2, “Kërkesat për kapacitet ekonomik-financiar” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.* Nga sa më sipër KPP, vëren se në tërësi kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor është korrekt dhe në proporcion me aktet ligjore dhe nënligjore konkretisht me nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43 pikat 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke respektuar në këtë mënyrë

parimin e barazisë në trajtimin e operatorëve ekonomike dhe duke u ngarkuar atyre të njëjtat të drejta dhe detyrime. Konkretisht me vendosjen e kriterit lidhur me xhiron e kërkuar, ku vlera e xhiros në të paktën një nga vitet e periudhës së sipërcituar, të jetë jo më e vogël se 40% vlerës së fondit limit të lotit ose shumatorës së loteve për të cilat konkuron operatori, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka vënë subjektet në pozita barazie, pasi një përcaktim i tillë vjen në proporcion me aktet ligjore dhe nënligjore të mësipërcituara, pra autoriteti kontraktor ka kërkuar që xhiro në të paktën një nga vitet e periudhës së sipërcituar, të jetë jo më e vogël se 40% vlerës së fondit limit të lotit ose shumatorës së loteve për të cilat konkuron operatori, ndërkohë nga ana tjetër madhësinë e xhiros e përcakton në proporcion edhe me aktet ligjore dhe nënligjore, pasi qëllimi i parashikimit ligjor në nenin 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar, është të vendosë një nivel tavan për autoritetin kontraktor sa i takon vlerës që mund të kërkohej në rastin e xhiros. Ligjvënësi ka theksuar se në çdo rast, vlera e xhiros minimale vjetore duhet të jetë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, duke qenë kështu detyrim për autoritetin kontraktor, për të mos kërkuar nën këtë tavan të parashikuar në ligj. KPP gjykon, se hartimi i kriterit në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, në mënyrën e formuluar në nenin 43 të VKM së sipërcituar, nuk shkakton konfuzion në radhët e operatorëve ekonomikë dhe njëherazi në punën e KVO-së gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pasi përputhet me qëllimin dhe frymën e dispozitës ligjore. Dispozita ligjore ka për qëllim të ndalojë autoritetet kontraktore të kërkojnë një vlerë minimumin sa 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, duke gjykuar, se një vlerë e tillë është e mjaftueshme për të dëshmuar përmbushjen e kapacitetit ekonomiko-financiar të operatorit ekonomik, si edhe nuk ka për qëllim të penalizojë ata operatorë ekonomikë që mund të kenë xhiro që e tejkalojnë vlerën minimale 40% të vlerës së parashikuar të kontratës. Në mënyrën si është ndërtuar kriteri në rastin konkret çon në përfundimin, se pranohet si xhiro një vërtetim i cili tejkalon vlerën e xhiros 40% të vlerës së parashikuar të kontratës. KPP gjykon, se me këtë kriter autoriteti kontraktor vjen në proporcion me frymën e ligjvënësit dhe më parashikimet ligjore të përcaktuara në nenin 77 të ligjit dhe në neni 43 të VKM, duke mos diskriminuar operatorët ekonomikë, duke mos shkelur parimin e mosdiskriminimit dhe barazisë së kandidatëve dhe parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe duke u ngarkuar operatorëve të njëjtat të drejta dhe detyrime. Në këto kushte, KPP vëren rregullsi dhe ligjshmëri në lidhje me përcaktimin e kriterit mbi paraqitjen e xhiros të realizuar në tre vitet e fundit financiare/ ushtrimore/ buxhetore (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros në të paktën një nga vitet e periudhës së sipërcituar, të jetë jo më e vogël se 40% vlerës së fondit limit të lotit ose shumatores së loteve për të cilat konkuron operatori. Lidhur me këtë konstatim KPP gjykon, se kriteret kualifikuese të procedurës së prokurimit duhet të përcaktohen, të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim kryerjen e një vlerësimi të drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Përcaktimi i saktë i kriterit si në rastin konkret, nuk shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Distributor of Medical Devices” SHPK, për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit



objekt-shqyrtimi, duke ndryshuar kriterin e veçantë të kualifikimit për nevojën e disponimit të një fuqie puntorie prej “...kërkojmë modifikimin e këtij kriteri si më poshtë vijon:

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për tregtimin e artikujve të ofruar që përfshin objekti i prokurimit.*

*Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.*

*Së pari: dukeënë se data e hapjes së ofertave është data 21.08.2023, datë kjo që përfshihet në peridhën kur shumica e kompanive prodhuese (në veçanti ato italiane) janë pushim gjithë muajin gusht, operatorët ekonomikë nuk mund të pajisen me një autorizim të tillë të veçantë për këtë procedurë prokurimi. Në këto kushte kufizohet konkurenca e lirë midis operatorëve ekonomikë.*

*Së dyti: autorizimet e prodhuesit lëshohen nga kompanitë prodhuese për të gjitha produktet që ato prodhojnë për një periudhë të caktuar kohore (1 ose 2 vjeçare) dhe një autorizim i tillë është i vlefshëm për të gjitha autoritetet kontraktore shqiptare. Pra kërkesa për një autorizim prodhuesi vetëm për këtë procedurë prokurimi është e tepër dhe përjashtuese.*

*Së treti: Periudha që përfshin objektin e prokurimit duhet të hiqet jo vetëm për dy arsytet e mësipërme por edhe sepse koha e fillimit të zbatimit të Marrëveshjes Kuadër është e pacaktuar madje e pacaktueshme pasi varet nga shumë faktorë të tillë si vlerësimi i ofertave, ankimimet e mundshme nga operatorët ekonomikë, kthimet e oërgjigjeve, dhënia e vendimit përfundimtar, zbatimi i vendimeve të KPP, njoftimet e fituesit, verifikimi i dokumentacionit të fituesit, etj. ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në pikën 2.3.4, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

*”2.3.4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar per periudhen që përfshin objekti i prokurimit.*

*Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës”.*

### ***Për secilin lot***

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe

jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.3. Në pikën 3 të nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.2.4. KPP gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve

ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. *Së pari*, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe *së dyti*, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin, nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik. Operatori ekonomik ankimues, kërkon të hiqet kriteri që *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale kërkohet kontratë bashkëpunimi dhe katalog për panelet biafciale dhe të provohet lidhja midis furnitorit dhe produktit të certifikuar. Qëllimi i autoritetit kontraktor në rastin konkret është realizimi në kohë dhe me cilësi i kontratës objekt-prokurimi. Për këtë shkak autoriteti kontraktor ka kërkuar autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar për periudhën që përfshin objekti i prokurimit. KPP e gjen kërkesën e autoritetit kontraktor të arsyeshme, proporcionale dhe në përputhje me natyrën e kontratës objekt-prokurimi, por autoriteti kontraktor me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes dhe rritjen e konkurrencës së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, nuk duhet të kufizohet vetëm te kërkesa për periudhën që përfshin objekti i prokurimit, por mund të pranojë edhe autorizim prodhuesi/distributor të autorizuar për tregtimin e artikujve objekt-prokurimi, me datën e hapjes së procedurës së prokurimit, me qëllim që t’i jepet garanci autoritetit kontraktor mbi prodhuesin dhe origjinën e mallit dhe në këtë kuadër është e rëndësishme që operatorët ekonomikë të dëshmojnë në çdo rast origjinalitetin e tij.*

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Distributor of Medical Devices” SHPK, për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, duke ndryshuar kriterin e veçantë të kualifikimit për nevojën e disponimit të një fuqie puntorie prej *“...Është e pamundur për OE të sjellin të gjitha mostrat në një kohë aq të shkurtër nisur nga fakti që jemi në muajin gusht kur prodhuesit janë mbyllur për pushime. Kërkesa për mostra është e tepërt përderisa në dokumentet e tenderit është kërkuar katalog për çdo artikull që të plotësojë specifikimet teknike.....Kërkesa për paraqitjen e mostrave 1 orë përpara përfundimit të dorëzimit të ofertave është gjithashtu e kundër ligjshme, pasi dorëzimi i mostrave bëhet në datën dhe orën kur bëhet dorëzimi i ofertave.*

*Sa më sipër, kërkojmë heqjen e kriterit të kualifikimit për paraqitjen e të gjitha mostrave si dhe heqjen e kërkesës për paraqitjen e disa mostrave 1 orë përpara hapjes së ofertave”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në pikën 2.3.8, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

2.3.8. Për të gjithë artikujt e ofertuar, duhet të paraqiten mostra deri në ditën e hapjes së ofertave dt. 21.08.2023 ora 09:00.

Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet, Spitalit Rajonal Vlore, te mbyllura në një zarf /kuti jotransparente të vulosur mbi të cilin të shenohet:

-“Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « ..... » dhe jo para dates së hapjes së ofertave.

-Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

-Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr.Rendor të Artikullit që përfaqëson.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet. **Për secilin lot.**

III.3.2. Në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” të dokumenteve të tenderit është parashikuar si më poshtë vijon:

Shtojca 6

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

## FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Loti 1 “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut”(në zbatim të kontratës konçesionare të laboratorëve)

Afatet e lëvrimit:

Emertimi	Specifikime	Njesia	Sasia e parashikuar	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
Tub me Trisodium Citrate Plasma (0.109M,3.2%) për teste koagulimi. Sistem i mbyllur hemogard me vakum. Tape Bojeqielli	1.8-2.7 ml, 13X75mm		30000	SRV	Sipas MK

Tuba me xhel per serum me aktivator koagulimi silica me kohe koagulimi jo me te madhe se 30 minuta. Sistem I mbyllur hemogard me vakum. Tape e Verdhe	3.5ml, 13x75mm - 5 ml, 13X100mm	Ndaresi xhel	65000	SRV	Sipas MK
Tuba me Litium Heparin per plazem, Sistem i mbyllur hemogard me vakum. Tapa Jeshile	2-4 ml, 13X75mm		250	SRV	Sipas MK
Tuba me K3 EDTA, Sistem I mbyllur hemogard me vakum. Tape lejla	2-4 ml, 13X75mm		60000	SRV	Sipas MK
Tub me Natrium Citrat per matjen e eritrosedimentacionit (ESR), Tape e zeze	1,6 - 5 ml	Te shoqerohet me stative mbajtes/mates ose me aparat mates ESR me kapacitet jo me pak se 60 teste ne ore.	700	SRV	Sipas MK
Tub me K2/K3EDTA per marrjen e gjakut kapilar per moshat pediatrike	Volum 250-500 µl (0.25-0.5 ml)		1500	SRV	Sipas MK
Tub me xhel per serum per marrjen e gjakut kapilar per moshat pediatrike	Volum 400-1000 µl (0.4-1 ml)		600	SRV	Sipas MK
Set Age per marrje gjaku, te pershtatshme per te gjithë tubat e sistemit me vakum te ofruar.	21 G, gjatesia e gjilperes 19 mm, gjatesia e tubit jo me e vogel se 17 cm	Rekomandohen sistemet e ages me kapuc per te shmangur kontaminimin ose me buton terheqes se ages per mbrojtje e personelit nga shpimi aksidental	64000	SRV	Sipas MK
Shiringe per marrje gjaku me litium heparine	1-3ml, 21-22G	E pershtatshme per gazet ne gjak	8000	SRV	Sipas MK
Gjilpere shpuese per marrjen e gjakut te foshnjave (lancet)	21-23G		200	SRV	Sipas MK
Zhgute (llastik) per shtrengimin e e krahut ku do merret gjaku			160	SRV	Sipas MK

Adaptor per tubat e gjakut, te pershtatshme per te gjithë tubat e sistemit me vakum te ofruar.			12000	SRV	Sipas MK
Age flutur per marrjen e gjakut	e pajisur me valvol		15000	SRV	Sipas MK

III.3.3. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.3.4. Neni 40, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.5. Në nenin 40 pika 6 germa a) të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 38 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të

paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.3.7 Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për paraqitjen e mostrave për secilin prej artikujve është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave. Në këto kushte, KPP gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave, është në përputhje me nenin 40, pika 6 gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, por kërkesa për dorëzimin e mostrave për të gjithë artikujt e kërkuar në shtojcën 6 të dokumenteve të tenderit “formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” të mallit është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni gjykon, se është e mjaftueshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin vetëm nga një ekzemplar (mostër) për produktet që do të prokurohen, më përdorim më të lartë për institucionin, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e dokumenteve të tenderit sipas konstatimeve të mësipërme.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,



## Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*” me Nr. **REF-77239-08-10-2023**, me objekt **Objekti i kontratës/ Marrëveshjes Kuadër**: “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” *ndarë në 2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”, **Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1** “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (**në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve**), me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 21.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Distributor of Medical Devices” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**